

Nga aktiviteti i Qendrës për Arsimim e Këshillim në Bazel (ABSM) të Zvicrës

Qendra e Bazelit jo vetëm vatër arsimore, por edhe vlerave të mirëfillta kulturore

Kjo qendër, e cila prej vitesh drejtohet me shumë sukses nga veprimtari Skender Nikoliqi, jo vetëm që ka ndihmuar në aftësimin e shumë të rinjve shqiptarë që të arsimohen e integrohen më lehtë, por edhe është shndërruar në një urë ndërlidhëse midis dy kulturave e dy vendeve.

Rexhep Rifati, Cyrih

Qendra për Arsimim e Këshillim në Bazel (ABSM), që më parë mbante emërtimin Këshillimorja shqiptare, tash e sa vite po jep një kontribut të veçantë për shkollimin dhe integrimin e të huajve. Në këtë kontekst me të madhe kanë përfituar edhe shqiptarët që jetojnë në kuadër të këtij kantoni e më gjerë. Kjo Qendër që drejtohet nga fillimi nga Skender Nikoliqi, me prejardhje nga Gjakova, prej vitesh është shndërruar edhe në një qendër të rëndësishme kulturore për ruajtjen, kultivimin dhe afirmimin e shqiptarëve: përmes promovimit të librave dhe takimeve me shkrimtarë nga Kosova apo diasporë, kontakte me krijues të fushave të ndryshme, si dhe artist të fushave të ndryshme të artit, në vazhdimësi nga viti në vit. Qendra jo vetëm që ka organizuar takime me shkrimtarë e publicistë nga viset shqiptare, por edhe ka botuar e sponsoruar edhe vepra me vlerë të autorëve shqiptarë e të huaj, në mënyrë që të kontribuojë thellimit të bashkëpunimit ndërkulturore me popujt tjerë e sidomos me popullin mik zviceran dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera që jetojnë në këtë mjedis shumetnik.

Edhe gjatë një vizite që i bë bëmë kësaj qendre në Bazel (që posedon me lokale të kompletuar për mbajtjen e kurseve të ndryshme për mësimin e gjuhës

gjermane e të tjera), vërejtëm interesimin në vazhdim për ndjekjen e këtyre kurseve ngase përmes tyre kandidatët me prejardhje të ndryshme në mesin e tyre edhe një numër i konsiderueshëm shqiptarësh arrin jo vetëm që të përvetësojnë më lehtë gjuhën e vendit por edhe të integrohen në rrjedhat e shoqërisë së këtushme.

Nga bashkëbiseduesi ynë, Skender Nikoliqi, mësuam se një kujdes i veçantë po i kushtohet organizimit të kurse të gjuhës gjermane dhe të integritimit për gra shqiptarë nga kantoni i Bazelit me qëllim rast ato gjatë ndjekjes së kurseve gëzojnë dhe një përkujdesje të veçantë për fëmijët e tyre nga disa femra kujdestare shqiptare që sigurojnë qendra. Ndërsa që kurset e integritimit ju mundësojnë kursistëve dhe kursistëve që të mësojnë më shumë për vendin ku jetojnë, të drejtat e tyre dhe obligimet, në mënyrë që të arrijnë një vetëdijësim më të shpejtë kulturor edhe përmes njohjes së kulturës së popullit zviceran dhe njohuri të tjera mbi sistemin social, ekonomik e politik të shtetit, ku aktualisht jetojnë. Qendra mësimin e kurseve e zhvillon në dy objekte, ku ka disa hapësira mësimore në 9 klasa me 7-8 mësimdhënës.

Duke e përcjellë për së afërmi tash e sa vite aktivitetin e shumëlojshëm e të gjithanshëm të kësaj qendre, shpesh i kemi shtruar pyetje vetes se si arrin një veprimtar i palodhshëm siç është Skender Nikoliqi, të organizojë e zhvillojë gjithë këtë aktivitet, madje duke e pasur këtë punë më tepër si punë vullnetare sesa profesionale, ngase ai punë të rregullt ka një vend tjetër pune. Përgjigjen e gjemë nga vetë drejtori:

"Fillimisht, në qytetin e Bazelit e hapën Këshillimorja shqiptare e cila më vonë u shndërrua në Qendër për Arsimim dhe Këshillim të emigrantëve. Ishte viti 1997, dhe një pjesë e rinisë dhe e të rriturve të ardhur që nga vitet nëntëdhjetë ishin në një pozitë të palakmueshme dhe pa ndonjë perspektivë të qartë për të ardhmen. Ndaj edhe lindi ideja që të ndërtohet një ekip punues i cili do të krijonte partneritet me institucionet zvicerane dhe bashkërisht të punonin për zgjidhjen e problemeve që kishin bashkatdhetarët tanë."



Skender Nikoliqi, drejtor i Qendrës për Arsimim e Këshillim në Bazel



Nga kabinetet e kursistëve në Bazel, ku aftësohen edhe mjaft femra shqiptare



Qendra organizatore edhe disa takimeve me shkrimtarë nga Kosova

Ndërkaq sa i përket shkollimit dhe integritimit të shqiptarëve S. Nikoliqi vazhdon: se ne si qendër, duke e parë nevojën që komuniteti shqiptar ka pasur vështrësi për integrim në shoqërinë zvicerane në njërin anë dhe duke qenë të vetëdijshëm për pamundësinë e kufizuar të institucioneve tona në Kosovë për të bërë diç në këtë drejtim, e pamë të nevojshme dhe si një domosdoshmëri që të hapet një qendër e nivelit të tillë në të cilën përpos këshillimeve konkrete, do të ofrohej edhe kurse të lëmenjve të ndryshme. Nisi me: kurse për gjuhën gjermane, informatikë, ndërtime, elektrikë, energji solare...

Nga bashkëbiseduesi mësojmë se suksesi shumëvjeçar i kësaj

qendre ndërlidhet me disa faktorë edhe atë në rend të parë duke krijuar ura të mira bashkëpunimi me institucionet gjegjëse zvicerane, por edhe përgatitjen profesionale dhe gatishmërinë e Stafit të kësaj Qendre që në periudha të ndryshme e edhe tash përbëhet nga bashkëpunëtorë të profileve të ndryshme deri në nivelin magjistrash e doktorësh shkencash.

Kjo qendër është ndër të pakat për të mos thënë e vetmja që një pjesë të aktivitetit e ka shtrirë edhe në Kosovë. Në shtator të vitit 2000 është hapur një zyre koordinatore e Qendrës për Arsimim dhe Këshillim, e cila ka bashkëpunuar me shkollat e mesme profesionale në Kosovë (Gjakovë, Pejë) ku është bërë në fillim edhe

përrurimi i më se 9 kabineteve/punishteve/klasa mësimi për mbajtjen e kurseve profesionale si (informatikë, elektrikë, administrative, të gjuhës angleze, energji solare, mekanik, për përpunimin e metaleve, etj), ku gjatë një viti kanë ndjekur kurset intensive në këto lëmi nga 600-700 individë.

Gjithashtu është bërë edhe trajnimin e mësimdhënësve të disa shkollave të mesme dhe fillore, ku trajnimin e tyre e kanë bërë ekspertë të kësaj fushe nga Zvicra. Format e bashkëpunimit me Kosovën edhe më tej po vazhdojnë, që nga periudha kur Zvicra përmjet ndërmjetësimit të kësaj qendre, financoi ngritjen e kabineteve mekanike dhe për energji solare, madje duke dërguar edhe ekspertë nga Zvicra në spitalin e Gjakovës. Ndërsa kurset etje kanë vazhduar edhe me shkollën e mesme teknike "Gjon Nikollë Kazazi", që është ngritur në sajë të donacioneve të Ileshkëvisë së Bazelit.

Të shkruash për veprimtarinë e Qendrës për Arsimim e Këshillim të Bazel nuk mjafton një shënim i zakonshëm siç është ky ngase veprimtaria e saj është shumë më e madhe e gjithanshme dhe shumëdimensionale. ■